

**Informacione për kontrollet mjekësore të azilkërkuesve  
në qendrat shëndetësore**

Si azilkërkues në qytetin e Freistaat Sachsen, ju do tu nënshtroheni kontrolleve mjekësore në qendrat shëndetësore përkatëse. Nëpërmjet këtyre kontrolleve, synohet të identifikohen sa më shpejt të jetë e mundur, sëmundjet ngjitëse, të kurohen dhe të merrren masa kundër përhapjes së tyre. Kontrolli mjekësor është në rradhë të parë shumë i rëndësishëm për ju vetë, por edhe për personat e tjerë, me të cilët ju do të ndani banesat e përbashkëta.

Kontrollet konsistojnë në një vizitë të përgjithshme (e nevojshme për të identifikuar sëmundjet ngjitëse), një radiografi për pjesën e krahërorit (duke filluar nga moshë 15-vjeçare) dhe testi i tuberkulines në lëkurë për fëmijët deri në moshën 15 vjeçare dhe gratë shtatëzëna. Për më tepër, për personat mbi moshën 13 vjeçare, kryhen analizat e gjakut për hepatitin A dhe B (verdhëza, sëmundje ngjitëse), si dhe për imunitetin ndaj fruthit, shytave, rubeolës dhe lisë së dhënve. Nëse dyshohet për sëmundje të zorrëve, bëhen analiza të feçes, për të identifikuar shkaktarë të mundshëm të infeksioneve të zorrëve.

Nëse mjeku i qendrës shëndetësore ka dyshime për sëmundje të tjera, mund të organizohen edhe kontrolle të mëtejshme.

Pasi të keni përfunduar kontrollet mjekësore, ju lëshohet një vërtetim përkatës nga mjeku.

Nëse është e nevojshme me qëllim që të ndalohet përhapja e sëmundjeve ngjitëse, ose nëse ka tregues të dukshëm që keni një sëmundje e cila ka nevojë për kurim, qendra shëndetësore do të duhet t'ua kalojë rezultatet e kontrolleve të kryera, institucioneve të tjerë përgjegjës.

Në të gjithë rastet e tjera, rezultatet e kontrolleve tuaja do tu kalohen institucioneve të tjerë, vetëm nëse ju e aproveni diçka të tillë.

Informacione të mëtejshme mbi kujdesin mjekësor për azilkërkuesit, mund të merrni në zyrën qendrore të të huajve, si dhe në qendrën shëndetësore që ju mbulon.

Jeni të lutur që të plotësoni formularin e anamnezës (pyetje mbi historikun e sëmundjeve) dhe t'ia dorëzoni atë mjekut të qendrës shëndetësore, që do t'ju bëjë vizitën. Ju lutemi të plotësoni edhe nga një formular edhe për secilin prej fëmijëve tuaj.

Në rast se është e nevojshme, qendrat shëndetësore ju ofrojnë përveç kontrolleve bazë, edhe këshillim për AIDS/HIV, hepatitin C dhe sëmundjet e tjera seksualisht të transmetueshme, si dhe testet laboratorike përkatëse. Kjo do të ishte veçanërisht e rëndësishme, nëse ka rrezik që të keni marrë në të shkuarën ndonjë prej këtyre sëmundjeve, ose nëse keni patur ndonjë prej shenjave karakteristike të këtyre sëmundjeve. Këto lloje kontrollesh janë fakultative dhe kryhen vetëm nëse ju dëshironi. Rezultatet e analizave do të trajtohen sigurisht në mënyrë konfidenciale.

## Shenja të sëmundjeve

### **Infeksioni AIDS/HIV**

AIDS është një sëmundje që prek sistemin imunitar të njeriut dhe vjen si pasojë e marrjes së virusit të imunodeficiences humane (HIV), i cili sulmon dhe shkatërron veçanërisht qelizat mbrojtëse të trupit.

Pak javë pas marrjes së HIV, vihen re simptoma të ngjashme me gripin, si temperaturë dhe dhembje trupi. Ecuria e mëtejshme e kësaj sëmundjeje është individuale dhe shumë e ndryshme, nga një rast në tjetrin. Si pasojë e dëmtimit gjithnjë e më tepër të sistemit imunitar, mund të shfaqen sëmundje të rënda, edhe nga shkaktarë që një trupi të shëndetshëm nuk do të mund t'i krijonin asnjë rrezik. Raste të tilla mund të jenë ndonjëherë edhe shfaqja e kancerit, apo e sëmundjeve të rënda të sistemit nervor qendror.

### **Hepatiti C**

Prekja nga virusi i hepatitit C (HCV) ndodh shpesh herë pa dhënë shenja të menjëhershme. Megjithatë, personi që mbarë këtë virus, mund ta transmetojë atë edhe në këtë fazë. Kur shfaqen simptomat, i sëmuri fillon të vuajë nga anoreksia, lodhja, dhembjet e muskujve dhe gjymtyrëve, dhembje të pjesës së sipërme të barkut, marrje mendsh, të përziera dhe temperaturë e lartë. Për më tepër, mund të vërehet edhe zverdhje e lëkurës dhe konjuktivës së syve. Vetëm në raste të rralla mund të ndodhë që kjo sëmundje të shërohet vetë. Në  $\frac{3}{4}$  e rasteve, sëmundja bëhet kronike. Pas disa vitesh mund të shfaqen dëmtime të rënda të mëlçisë.

### **Sifilizi**

Sifilizi është një sëmundje ngjitëse, e përhapur në mbarë botën. Ajo shkaktohet nga baktere mikroskopike, në formë spirale dhe kalon në disa stadi. Shenjat e sëmundjes janë shumë të ndryshme dhe të paqarta.

Rreth 3 javë pas prekjes nga sëmundja, mund të shfaqen filluska dhe më pas plagë (pa dhembje) në organin nga ku ka hyrë virusi (p.sh. organet gjinore). Këto shenja largohen vetë, pa kurim. Megjithatë infeksioni nuk mund të largohet patjetër kaq lehtë dhe mund të shndërrohet në një proces kronik. Më pas mund të shfaqen njolla të kuqe apo limfadenoma nëpër të gjithë trupin. Shumë vite pas marrjes së virusit, mund të shfaqen probleme në organe të ndryshme, si zemra, arteriet, mëlçia, kyçet, apo sëmundje të sistemit nervor.

Nëse sëmundja merret gjatë shtatëzanisë, bakteret mund të shkaktojnë dëme të rënda tek foshnja.